

UDHA E KRYQIT



Hyrje

Bëhu i vetëdijshtëm se Jezusi është para teje. Lutu të të udhëzojë në fshehtësinë e vetëmohimit. Jezus, dëshiroj të të takoj, e të të marrë me vete. Mari, më mëso gjithmonë t'u rri besnik fjalëve të Jezusit në ecje drejt majës së Kalvarit dhe jetës sime. Më ndihmo që të përgjigjem si ti: "Jo vullneti im, por vullneti yt u bëftë, o Atë!" Le të dhe të veproj ashtu si kërkon Jezusi. O Atë, ja ku jam. Dëshiroj të hyj në fshehtësinë e Birit tënd, Jezusit, që të dallosh në mua birin (bijen) tënde i cili (e cila) kthehet te ti, që jeton e sundon në shekuj të shekujve. Amen.

Rrinte Zoja tuj lotue
afër kryqit tuj shikue
Krishtin pezull kryqëzue

Ref:

Nana e dashtun t' lus pa pra
varr't e t' Birit tand pa da
gjurma n' zemër me m' i ba

TË NDALURIT I

Jezu Krishtin e gjykojnë për vdekje

M: T' adhurojmë, o Krisht, e t' bekojmë!

P: Se me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

Kryqi i parë: ta pranosh dënimin.

Dëgjoje Jezusin që të thotë: edhe mua më dënuan krerët e

UDHA E KRYQIT

shtetit dhe të fesë së bashku me popullin edhe pse i dëgjuan mësimet e mia. Apostujt dhe miqtë iken dhe u shpërndanë. Deri dje më lavdëruan, mahniteshin për mrekullitë e mia, dëshironin të më preknin dhe ma dhanë besën për miqësi të përjetshme, ndërsa tani ma kthyen shpinën. Këtu para Pilatit kërkojnë vdekjen time në kryq. Pilati, njeri i huaj në vendin tim, dëshiroi të më lironte, por populli im kërkoi nga ai të më dënonte dhe Pilati e bëri këtë. Njerëzit apo miqtë më të ngushtë që ke do të dënojnë dhe do të gjykojnë edhe ty. Kjo nuk do të thotë se je fajtor. Nuk mund t'i ikesh gjykimit dhe s'mund të mbështetesh në njerëz. Hyji është mbështetja e vetme që nuk lëkundet kurrë. Kryqi të liron nga njerëzit, në të cilët mbështetesh dhe thërret që të qëndrosh në mua. Kur të gjykojnë njerëzit eja tek unë, sepse edhe mua më gjykuan dhe më dënuan. Mos u mbro kur të dënojnë! Dënimi nuk do të shkatërrojë, por të bie tek unë dhe të sjellë lumturi. Ky është kryqi i parë për mua dhe për ty. Mos ke frikë! Ky dënim është dera nëpër të cilën kalon tek unë. Në këtë gjykim të padrejtë do të më takosh mua dhe askush më nuk ka mundësi të të gjykojë.

Lavdi Atit....

M: Mëshirë, o Zot, për ne !

P: Mëshirë për ne!

Heshta zemrën prej trishtimit
prej ezgjetit, prej idhnimit
Zoj's përshkue ia kishte shqimit

UDHA E KRYQIT

TË NDALURIT II

Jezu Krishti është ngarkuar me kryq

M: T'adhurojmë, o Krisht, e t'bekojmë!

P: Se me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

Kryqi i dytë: ta pranosh përditshmërinë.

Pata mundësi të mbrohem ose të kërkoja të më mbronin. Mund të thoja jam i drejtë, përse te vuaj, por e pranova kryqin pa e ngritur zërin fare. Çdo çast i jetës është kryq. Ke mundësi ta pranosh, apo mos ta pranosh. Ke mundësi të ikësh, apo të përkulesh para tij. Unë e pranova. Tani e di ku mund të më gjesh. Fuqia jote nuk është në ikje. Secili moment kërkon përcaktim që ta lësh vetveten e të nisesh pas meje. Ky është kryqi i dytë. Pak kush e njeh. Njerëzit kërkojnë kryqe të jashtëzakonshme, ndërsa kryqi është këtu, në pranimin e jetës së përditëshme. Në kryqin që e pranon fiton shumë hire dhe feja e jote rritet si lumi pas shirave.

Lavdi Atit...

M: Mëshirë, o Zot, për ne !

P: Mëshirë për ne!

Oh sa n'vajtë e sa n'ankim
ke n'atë çast pa pasë një g'zim
Nana e Krishtit veç bekim

UDHA E KRYQIT

TË NDALURIT III

Jezu Krishti bie të parën herë nën kryq

M: T'adhurojmë, o Krisht, e t'bekojmë!

P: Se me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

Kryqi i tretë: të kesh guxim të rrëzohesh.

Të rrëzohesh është gjë shumë e vështirë, sepse të gjithë dëshirojnë të qëndrojnë në këmbë dhe të korrin fitore. Unë jam Hyj e prapëseprapë rash nën kryq. Të gjithë i panë mrekullitë që bëra dhe u mahniten e tani më shohin të rrëzuar, të poshtëruar dhe të munduar. Merr guxim kur të rrëzohesh dhe mos e fsheh rënien tënde, por pranoje! Nuk ke mundësi të jesh diçka tjetër në tokë. Këtu je për të vdekur. Sepse “kush e humb jetën e vet, do ta gjejë”. Përse ke frikë nga rrëzimet tua? Përse nuk ke guxim t'i shikosh njerëzit në sy kur ke pësuar humbje, kur të tjerët janë më të aftë se ti? Përse ke frikë kur të rëndojnë mëkatet? Ti lufton që të bëhesh i mirë. Ja, kur rrëzohesh vjen tek unë. Mos ke frikë! Ramja nuk është përfundimi i të gjithave. Përse e shikon kaq tmerrshëm rrëzimin? Përse gjithë ky turp? Rrëzimi ndodhi që të vish më afër meje, që unë të të çoj me duart e mia e të të marrë në krah. Kur të kuptosh se edhe unë jam rrëzuar, atëherë në rënien tënde do të dallosh fytyrën time dhe së bashku do të korrin fitore mbi rrëzime dhe mëkate. Ka shumë rëndësi që të mos mbetesh i vetmuar në rrëzime, por të vish tek unë.

Lavdi Atit....

UDHA E KRYQIT

M: Mëshirë, o Zot, për ne !

P: Mëshirë për ne!

Kjate e dnestë e dhimshmja Nanë
mundue Krishtin për gjithë anë
pa mujtë kush një ndihmë me i dhanë

TË NDALURIT IV

Jezu Krishti hasë në Nënë e vet

M: T'adhurojmë, o Krisht, e t'bekojmë!

P: Se me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

Kryqi i katërt: t'i bësh të vuajnë ata që i dashuron.

Është e pamundur të mos i bësh të vuajnë ata që i dashuron. Pata mundësi t'i ikja takimit me nënën time. A e di çka do të thotë ta takosh personin e dashur që e ke dëshpëruar? Kam qenë i braktisur dhe i poshtëruar prej popullit mbarë, si kundërshtar i Hyjit dhe ngashnjyes. Nëna ime i dinte të gjitha. E pa dhimbjen fizike dhe vuajtjen e brendshme dhe me shikoi në sy. Ky është kryqi - ta shikosh në sy njeriun më të dashur kur të gjithë të poshtërojnë. Njeriu i dashur është e pamundur të mos dëshpërohet. Nuk ka mundësi të ruhet. Mos e largo këtë kryq. Do të më gjesh kur të shikosh se i ke bërë të vuajnë miqtë e tu dhe ata që të duan. A shikon si rrëzimi yt u shkakton atyre dhimbje? Kjo gjë të shkakton plagë. Nëna ime në rrëzimin tim e kuptoi se kush jam unë. Kur në të vdiq edhe dëshira e fundit për fitoren time, në atë çast

UDHA E KRYQIT

shndriti feja e saj me dritë të vërtetë. Mikun do ta fitosh kur në ty vdes çdo gjë e mirë. Atëherë ai të sheh vetëm ty. Pranojë shkandujt e pashmangshëm. Prano edhe faktin se ke mundësi të dëshpërohesh. Aty do të më gjesh bashkë më nënën time.

Lavdi Atit....

M: Mëshirë, o Zot, për ne !

P: Mëshirë për ne!

Tuj kqyrë Nanën e Tenzot
afër Krishtit me varrë plot
nuk ka njeri që s' derdhë lot

TË NDALURIT V

Simon Cireneu i ndihmon Jezu Krishti në bartjen e kryqit

M: T'adhurojmë, o Krisht, e t'bekojmë!

P: Se me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

Kryqi i pestë: lejo tjetrin të të ndihmojë!

Të gjithë më poshtëruan. Edhe ata që i shërova edhe të afërmit e mi më lanë krejtësisht vetëm. Plot plagë dhe gjak, i tronditur nga takimi me nënën, kur më së tepërmi kisha nevojë për dashuri, e dhunuan një njëri të më ndihmonte. Prita ndihmë nga mëshira dhe dashuria. Simonin e detyruan ta mbarte kryqin tim. Ky është kryqi - kur nuk i dhimbesh askujt dhe nuk të do askush. Kur e

UDHA E KRYQIT

pranon këtë gjë, atëherë unë jam aty dhe nuk je i vetmuar. Edhe një gjë: merr guxim dhe lejo të të ndihmojnë të tjerët. I lejova edhe unë edhe pse jam i gjithëpushtetshëm. Lejo që të tjerët të jenë më të fortë, të të mbrojnë se ke nevojë për ta dhe të pranosh ndihmën. Ky është kryqi nga i cili nuk ke mundësi të ikësh. Kupto se kjo është dera që çon tek unë. Mos u çudit nëse çdo gjë në ty e kundërshton këtë kryq. Shpirti lufton kundër trupit, e trupi kundër shpirtit. Mos harro. Merre kryqin tënd dhe eja pas meje. Do të takohemi.

Lavdi Atit....

M: Mëshirë, o Zot, për ne !

P: Mëshirë për ne!

Kush sheh Zojën n'atë ezgjet
gati dekun për djalë t'vet
pa dnesue, jo, nuk jetë

TË NDALURIT VI

Veronika ia fshin fytyrën Jezu Krishtit

M: T'adhurojmë, o Krisht, e t'bekojmë!

P: Se me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

Kryqi i gjashtë: të dish të pranosh pa mundësi që të kthesh.

Të gjitha m'i morën. Të gjithë më braktisën. Mbeta krejtësisht i vetmuar, pa asgjë pas shpirtit, në udhë për

UDHA E KRYQIT

vdekje. Në këto momente me afrohet Veronika dhe ma fshin fytyrën me shami. A e di çka do të thotë kjo? Me preku në zemër. Ndieja falënderim, por s'kisha si t'ia ktheja. Në atë rast kisha vetëm vuajtje dhe mundime. U kujtova dhe ja dhurova fytyrën time të përgjakur në rubë. Kryq është edhe kur lejon që njerëzit të bëjnë mirë, e ti nuk ke si t'ua kthesh. Merr guxim e bëj ashtu siç bëra unë. Lejo që njerëzit të bëjnë mirë edhe kur nuk ke me çka t'ua kthesh. Lejo që t'u mbetesh borxh. Nuk duhet të paguash gjithmonë, por si pagesë jepe vetveten. Mesohu të pranosh dhurata, të cilat nuk ke mundësi t'i kthesh pa shpirt tregtie. Kjo derë të sjellë tek unë. Prano turpin se nuk ke më çka t'ua kthesh. Atëherë vjen tek unë, sepse Ati im dhuron gjithmonë e nuk kërkon pagesë. I përngjan burimit që jep ujë të pastër pa pagesë dhe askurrë nuk shterret. Në këtë menyrë bëhesh biri i Atit tim. Ja kryqi yt i gjashtë - Zotit nuk mund t'ia kthesh krejt dashurinë e tij. Do të jesh si fëmijë që e gëzon dashurinë e babait dhe nënës së tij.

Lavdi Atit....

M: Mëshirë, o Zot, për ne !

P: Mëshirë për ne!

M'katet tona me i resitë
e pa Krishtin krejt molitë
prej së rrahnash t'asaj ditë

UDHA E KRYQIT

TË NDALURIT VII

Jezu Krishti bie të dytën herë nën kryq

M: T'adhurojmë, o Krisht, e t'bekojmë!

P: Se me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

Kryqi i shtatë: të biesh përsëri.

Një herë jam rrëzuar. Të gjithë menduan se jam i fortë. Atëherë u rrëzova për herë të dytë. E dija se ky rrëzim do t'i shkaktonte plagë nënës sime, do të shkaktonte përqeshje të papërshtueshme të kundërshtarët, do të shkandullonte dhe do të dëshpëronte miqtë. Ligësia ime i shkandulloi të gjithë njerëzit. Pyetën: a është ky më të vërtetë Zot? E pranova edhe në kryq. Ati dëshiroi të tregonte se Ai është në mua më i fortë se cilido shkandull. Kur rrëzohesh të parën herë, ke arsyetim. Por, kur arrinë mossuksesi edhe të dytën herë, atëherë secili ka mundësi të thotë se je krejtësisht i pavlerë. Ti dëshiron ta kundërshtosh kryqin. Do të arsyetohesh dhe t'i përmirësosh të gjitha. Kjo gjë të largon prej meje. Në këtë mënyrë nuk më dëshmon mua, por veten dhe fuqinë tënde. Dije se do të rrëzohesh gjithmonë. Unë ta jap dorën e ti do të ngrihesh. Atëherë do të thonë: shiko, dikush e ngriti. Kryqi i shtatë për ty është të rrëzohesh dhe ta pranosh rrëzimin. Mos iu frikëso rrëzimit, por kthehu tek unë. Nëse e njeh mirë këtë kryq, në të do të më gjesh. Në këtë mënyrë pëson trupi dhe fiton shpirti.

Lavdi Atit....

UDHA E KRYQIT

M: Mëshirë, o Zot, për ne !

P: Mëshirë për ne!

N' mal t' Kalvarit kur e lëshoi
veten n' kryq e kur mbaroi
Krishtin pa e dhimshmja Zojë

TË NDALURIT VIII

Jezu Krishti ngushëllon gratë

M: T' adhurojmë, o Krisht, e t' bekojmë!

P: Se me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

Kryqi i tetë: t' i ngushëllosh ata që të ngushëllojnë ty.

Gratë më dëgjuan, më deshën dhe më besuan. I bekova fëmijët e tyre. Më shikonin më zemër. Nuk mund ta kuptonin si më kishin gjykuar me vdekje. Për këtë gjë qanin. E dinin se në këtë mënyrë ishte gjykuar jeta. I kishte mbuluar dhimbja. Atëherë i ngushëllova. Ky është kryqi - të tejkalosh mundimet dhe dhimbjen tënde, të ngrihesh dhe ta shikosh fitoren përtej kryqit. Asnjë dhimbje nuk është tragjike. Vetëm verbëria dhe zemërgurtësia janë tragjike: kur nuk shikon se pas çdo vdekje vjen ngjallja, pas çdo sëmundje shërimi, pas çdo ikjeje ardhja... Fitorja fillon më ngushëllimin e të tjerëve atëherë kur vet ke nevojë për ngushëllim. Atëherë përdëllimi i plotë të vjen prej Hyjit. Ji i guximshëm dhe mos u mbështet në ngushëllimin njerëzor, por lype fuqinë e Hyjit. Ajo korr fitore mbi botën. Kjo është udha e kryqit që shpie në jetë. Mos lejo të arrijë

UDHA E KRYQIT

momenti kur ti do ta qashë vetveten. Kur ke shumë plagë e dhimbje ngushëllo të tjerët, sepse atëherë do të më gjeshë mua. Hape edhe këtë derë, pas saj të pres unë që të mbështetësh në mua.

Lavdi Atit....

M: Mëshirë, o Zot, për ne !

P: Mëshirë për ne !

Deh, oj Nanë ti me dashni
dhimbjen tane ban ta ndij
sa t'jetoj n'ket shekull t'zi

TË NDALURIT IX

Jezusi Krishti bie të tretën herë nën kryq

M: T'adhurojmë, o Krisht, e t'bekojmë!

P: Se me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

Kryqi i nëntë: të pësosh disfatë të plotë.

U rrëzova edhe të tretën herë. Të gjithë menduan se pësova disfatë të plotë. Kur të gjithë llogaritën se nuk mund të shkoja përpara, u ngrita, e mora kryqin dhe e barta deri në Golgotë. Edhe atëherë kur të gjithë mendojnë se nuk ka kurrfarë rrugëdalje tjetër, prapë ekziston mundësia e re. Do të vijë çasti kur edhe ty do të thonë: “s’ka gjë prej tij, çdo

UDHA E KRYQIT

gjë mbaroi”. Edhe ti vetë do të mendosh: “s’mundem më”. Do të vijë momenti i paaftësisë së plotë. Ky do të jetë momenti i disfatës sate të plotë. E kuptove se nuk ke rrugëdalje tjetër. A do të deshpërohesh atëherë? Mos ke frikë! Kjo është vetëm një derë nëpër të cilën ke mundësi të më gjesh përsëri. Kur nuk beson më në vetvete, atëherë më gjejë mua. Më kërko me gjithë zemër dhe unë do të përgjigjem. Ky është kryqi: të pësosh disfatë të plotë, të jesh i braktisur krejtësisht, të vdesësh, askush të mos shpresojë më në ty, kur të gjithë humbin shpresën se prej teje mund të dalë diçka e mirë. Ky kryq të sjellë fuqishëm tek unë dhe të bënë të aftë për dërgim deri në skajin e tokës. A e pranon ti këtë? Mos u frikëso! Unë jam me ty. Unë e ngadhënjeva botën.

Lavdi Atit....

M: Mëshirë, o Zot, për ne !

P: Mëshirë për ne !

Deh, oj Nanë ti me dashni
dhimbjen tane ban ta ndij
sa t’jetoj n’ket shekull t’zi

UDHA E KRYQIT

TË NDALURIT IX

Jezusi Krishti bie të tretën herë nën kryq

M: T'adhurojmë, o Krisht, e t'bekojmë!

P: Se me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

Kryqi i dhjetë: të lejosh të të zhveshin.

Lejova të më zhveshnin, që të mi merrin petkat më intime që kisha. Lejova që e keqja e ferrit të marrë hov në mua. Lejova të më çnderonin duke më marr fytyrën e duke më çitur lakuriq përpara të gjithëve. Gjithnjë do ta kesh një dëshirë të kesh vetëm për veten tënde një pjesë të vogël të jetës dhe të botës ku do të jesh krejtësisht i vetmuar. Diçka që nuk ke dëshirë ta shikojnë as ta prekin njerëzit. Diçka që është vetëm e jotja. Diçka para të cilës të vjen turp edhe ty. Ke diçka që nuk duhet ta dijë askush, sepse mund të të çnderojnë. Këtë kënd e ruan dhe e fsheh. Do të mendosh se për këtë gjë ke të drejtë. Këtu i frikësohesh më së shumti mëkatit. Ke dëshirë me çdo kusht që ta ruash këtë pjesë të intimitetit tënd. Për këtë gjë do të luftosh. Por, vjen çasti kur as kjo nuk ruhet dot. Lypset të kalosh edhe nëpër këtë kryq. Në një moment duhet t'i dorëzosh të gjitha, sepse asgjë më nuk është e jotja. Edhe të fshehtë e fundit do ta marrin. Prandaj më mirë falja Hyjit të gjitha. E vetmja pikë intime do të jemi ti, Ati dhe unë. Trupi pa petka nuk është i vetmi kryq. Kur ta zhveshin shpirtin do të ndiesh dhimbje edhe më të madhe. Mëkatet që moti të zhveshën. Merre këtë kryq dhe dije se më askush nuk ka mundësi të të zhveshë. Lejoje Atin ta japë petkun e ri. Falja fshehtësinë tënde. Lejo të të veshi më pafajësi të plotë. Mundohesh kot

UDHA E KRYQIT

ta ruash pafajësinë. Sot prano se je i lig. Ky është kryqi i dhjetë – kryqi i turpit, i dëshirës për të mbetur i pastër, kryqi i frikës që dikush të dijë për mëkatën tënd. Merre këtë kryqi e shpejt do të më gjesh. Të pres këtu. Atëherë nuk do të kesh frikë. Vetëm prano se je i dobët, se nuk je i fortë, por njeri me intimitet të çnderuar. Këtu do të takohemi. Atëherë askush më nuk ka mundësi të të çnderojë.

Lavdi Atit....

M: Mëshirë, o Zot, për ne !

P: Mëshirë për ne!

Nana e dashtun t' lus pa pra
varr't e t' Birit tand pa da
gjurma n' zemër me m' i ba

TË NDALURIT XI

Jezu Krishtin e gozhdojnë në kryqi

M: T' adhurojmë, o Krisht, e t' bekojmë!

P: Se me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

Kryqi i njëmbëdhjetë: të gozhdohesh në kryqin tënd.

Derisa e mbart kryqin në krah, ende ke mundësi për ta hedhur, por kur njëherë të jesh i gozhduar në të, nuk ke ndarje nga kryqi. Tani e di se kryqi është fati yt deri në vdekje. Ja, kjo është gjëja më e rëndë. Ti dëshiron të

UDHA E KRYQIT

lirohesh prej kryqeve, por je i gozhduar në to. Kryqi është vendi i vdekjes. Njerëzit do të gozhdojnë në kryq. Do të dëshpërohesh, apo do të mbështetësh në mua? Kryqi duhet mbartur deri në fund. Kot mundohesh për t'u liruar prej tij. Duhet ta marrësh më guxim, e të vish tek unë. Atëherë do të vdesësh dhe do të fillosh të jetosh. Mos ke frikë! Kam dëshirë vetëm të mos gënjuhesh duke pritur diçka tjetër. Kryqet mbeten deri në fund dhe sa më shpejt të vdesësh, aq më parë do të ngjallësh. Sa më parë të pajtohesh me të, aq më shpejt do të më takosh. Mos e harro kryqin e njëmbëdhjetë! Ky është takimi ynë, të cilit i gëzohem pa masë.

Lavdi Atit....

M: Mëshirë, o Zot, për ne !

P: Mëshirë për ne!

Ti pjestar m'ban përgjithmonë
n'atë mundim që për faj tonë
hoq mbi kryq Shëlbuesi jonë

TË NDALURIT XII

Jezu Krishti vdes në kryq

M: T'adhurojmë, o Krisht, e t'bekojmë!

P: Se me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

Kryqi i dymbëdhjetë: të vdesësh në kryq.

UDHA E KRYQIT

Vdekja! Dal prej tokës të jetoj e jo të zhdukem. Vdekja ime është plotësim i vullnetit të Atit. Për këtë arsye thashë: “O Atë, në duart e tua po e lëshoj shpirtin tim!”. E plotësova vullnetin e Atit. Ti mendon se vdekja është fundi dhe për këtë arsye ke frikë. Kundërshton!? Do të vuash derisa nuk do të pajtohesh. Kur ta pranosh vdekjen, do të korrësh fitore mbi të. Atëherë do të më gjesh. Jam larg derisa ti kundërshton vdekjen dhe më lutesh që të liroj prej saj. Kupto, do të më gjesh në vdekje. Vdekja rrënon çdo gjë që është mëkatore dhe e vdekshme në ty, ndërsa unë e shkatërroj vdekjen. Vdekja të liron nga kryqet, e unë të liroj prej vdekjes. Shikoje sot vdekjen në sy. Merre këtë kryq si dhuratë të Atit. Derisa kundërshton vdekjen nuk ke mundësi të më gjesh. Kryqi i dymbëdhjetë i përngjan festës, kulmit dhe përfundimit të gjithave. Në të vërtetë ky është fillimi i Jetës.

Lavdi Atit....

M: Mëshirë, o Zot, për ne !

P: Mëshirë për ne!

Afër krygjës t’Birit Tenzot
m’ban, o Zojë, me derdhun lot
der’sa t’kemi jetë e mot

UDHA E KRYQIT

TË NDALURIT XIII

Jezu Krishtin e ulin prej kryqit

M: T'adhurojmë, o Krisht, e t'bekojmë!

P: Se me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

Kryqi i trembëdhjetë: mos t'i marrësh frytet e punës sate.

Miqtë m'u afruan vetëm pas vdekjes. Ti je farë e kohërave të ardhshme e dëshiron të shohësh menjëherë frytet e duarve tua. Nxënësit e mi shpeshherë vdesin pa kurrfarë shprese dhe në mënyrë të turpshme. Të tjerët korrin fryte nga plagët e tyre, e kanë gëzimin dhe jetën. Ty të vendosa që të mbjellësh për botën e re. Ky është kryqi yt. Ta jap fenë, sepse gjatë jetës sate do të shohesh shumë pak suksese. Pas vdekjes do të të lavdërojnë. Atëherë do të afrohen dhe do të ulin prej kryqit. Amshimin do ta jetosh pa kryq, sepse gjatë kësaj jete pate guxim të qëndrosh në të. Të punosh e të mos gëzosh frytin e punës, ky është kryqi i trembëdhjetë. Puna e guximshme është vetëm kjo – të mbjellësh për të korrur të tjerët. Këtu takohemi unë e ti. Këtu është ringjallja.

Lavdi Atit....

M: Mëshirë, o Zot, për ne !

P: Mëshirë për ne!

Afër kryqit tuj gjimue
afër teje tuj lotue
kisha t'kjaj unë pa pushue

UDHA E KRYQIT

TË NDALURIT XIV

Jezu Krishtin e varrosin

M: T'adhurojmë, o Krisht, e t'bekojmë!

P: Se me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

Kryqi i katërmbëdhjetë: të mbetesh pa shpresë tek njerëzit.

Me vendosjen e trupin tim në varr miqtë menduan se më bënë një nder shumë të madh. U kujdesuan për trup. Kjo ishte ajo që patën mundësi të bënin për mua. Harruan krejtësishtë se u pata thënë se kjo zgjat vetëm tri ditë. Vdekja nuk ka zotësi mbi mua. Të frikëson varri? Kur mbyllet gropa e varrit ti nuk je më. Kur pas teje zhduken të gjitha gjurmët, çfarë të bësh atëherë? Kur e di se askush nuk do të vijë me ty në varrin tënd, kur do të përfundosh i panjohur dhe i mjerë, kur asgjë nuk mbetet pas teje, atëherë do të më takosh! Ky është kryqi – të zhdukësh dëshirën e fundit, për të lënë diçka pas vetes. Dëshira që të lësh diçka të pengon të bëhesh dritë. Si do të më gjesh mua që dhash gjithçka, ti që kë frikë të shtrihesh në varrin e egoizmit dhe të varrosesh? Derisa kalon tek unë e nuk i rrënon urat pas vetes, si mund të takohemi? E pra, ky është momenti kur kam mundësi ta jap jetën e re. Ky është kryqi i katërmbëdhjetë dhe në të rrijnë ata që do të ngjallën. Sa më gëzon varri i mendjemadhësisë sate! Por ti ende nuk i dorëzohesh varrit, ende i kundërshton vdekjes së jetës sate. Për këtë arsye je i vdekur. Kur të hysh në varr të mendjemadhësisë dhe të vdesësh për vetvete, atëherë do të ngjallësh për jeten time. Vetëm i vdekuri ka mundësi të ngjallet. Sepse, vdekja ende nuk e zhduk mbrojtjen e

UDHA E KRYQIT

fundit! Mos u frikëso! Këtu është fjala për urë mes meje dhe teje. Vdekja për mëkatin është gëzimi i përqaimit tim me ty, shpërthimi i dashurisë. Unë e kalova këtë rrugë dhe tani të pres ty. A kupton se nuk kam ikur nga toka? Përpara isha mysafir në tokë. Tani jam zotëri i tokës. Nëse do, ti je si unë. Dhuroja vdekjes pasurinë e saj. Mos shiko varrin si vend pa shpresë dhe përfundim të të gjithave, por si lindje dhe si fillim. Le të vdes mendjemadhësia jote! Mëngjesi i të ngjallurit është afër.

Lavdi Atit....

M: Mëshirë, o Zot, për ne !

P: Mëshirë për ne!

O Zojë Virgjën, Nanë e dli­rë
lute Zotin t'ketë mëshirë
ti shëlbim prej si na nxier

UDHA E KRYQIT

PËRFUNDIMI

O Atë, po të falënderoj për këtë udhë kryqi. I shikova kryqet e mia, të cilat më duhet çdo ditë t'i marr në krah dhe të nisem pas Birit tënd. Tani e di si pranohet, mohohet, falet dhe para të gjithave si dashurohet! Tani kuptova se si vdiqet para vdekjes dhe shkohet në takim me Jetën. Të falënderoj që tani po hyj në Mbretërinë tënde! Dola nga vullneti im kryengritës dhe po hyj në vullnetin tënd. Po bëhem pjestar i natyrës sate, fëmijë i yti, gëzimi yt. O Atë, lejo që sot të ndodhë ngjallja ime! AMEN.

